

Procesverbal

Nga Mbledhja I (e parë) e rregullt e Komitetit për Komunitete, e mbajtur më datë: 30.01.2024

Rend Dite

- 1) Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
- 2) Shqyrtimi i materialit të Kuvendit për Seancën I (e parë),
- 3) Eventuale.

Miralem Rahte: Të nderuar anëtarë të Komitetit për Komunitete, përfaqësues të OSBE-së, të gjithë të pranishmit, po hap takimin e 1-të të Komitetit për Komunitete për këtë vit, para fillimit të këtij takimi dua të konstatoj nëse kemi kuorum. Meqenëse kemi Më lejoni të bëj një pyetje, a e kanë marrë materialin të gjithë anëtarët e Komisionit për Komunitete në kohën e përcaktuar me ligj, të përkthyer në gjuhët tuaja amtare? A ka dikush ndonjë fjalë për rendin e ditës? Po hedh në votim miratimin e axhendës së sotme të propozuar. Kush është pro-, kundër-, abstenime-. Meqenëse rendi i ditës është miratuar, kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës.

Pika I - Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhjet e mëparshme

Z. Miralem Rahte - A ka dikush fjalën në lidhje me këtë pikë të rendit të ditës dhe procesverbalit. Meqenëse nuk ka, e vura në votim miratimin e kësaj pike të rendit të ditës. Kush është -, kundër-, abstenim-. Konkludoj se kjo pikë e rendit të ditës është miratuar.

Pika II - Shqyrtimi i materialeve të Kuvendit për 1 seancë,

Z. Miralem Rahte - Materiali i Kuvendit ka 17 pika, menjëherë do të kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës. Kërkesë për ndryshimin e emrit të rrugës Hajdet në Haxhi Rrahmani. A ka ndonjë diskutues? Meqenëse nuk ka asnjë, Kush është për-, kundër-, abstenoi-. Meqenëse rendi i ditës është miratuar, kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës.

- Në këtë pikë kemi plan veprimi për barazinë e punës, fjalën ia jap Lindita Piraj.

Lindita Kozmaqi Piraj: Përshëndetje kryesues dhe ju të gjithë anëtarë të Komitetit, të pranishëm dhe mysafirë! Komuna e Dragashit ka pas fatin me qenë në mesin e 11 komunave të tjera në Kosovë, ku është hartuar Plani Lokal i Veprimit për Barazi Gjinore, dhe i cili ka direkt një ndikim të madh në performancën komunale, duke i përfshirë pothuajse të gjitha drejtoritë komunale që

janë. Domethënë, nuk është një Plan i zyrtarës për Barazi Gjinore apo i Zyrës, por është Plan komunal për Barazi Gjinore. Metodologjia e hartimit të këtij Plani ka qenë gjithëpërfshirëse dhe u zhvillua përmes hapave si në vijim. Është ngrit Grupi Punues për përgatitjen e këtij Plani, me vendim të kryetarit, ku është themeluar ky grup i përbërë prej 11 zyrtarëve, konkretisht z.Qamil Kolloni ka qenë kryetar i grupit, mandej unë, Adem Emini, Zeni Krasniqi, Ibrahim Gashi, Liridona Misinaj, Behar Brenoli, Uzair Hamza, Fitim Kurteshi, Salmira Usmeni dhe Mimoza Berisha. Siç e shihni, janë drejtorë dhe përfaqësues të institucioneve, pothuajse nga të gjitha drejtoritë e Komunës. Është bërë analiza e situatës fillimisht, përmes të dhënave, informacioneve eZK istuese. Mandej janë përcaktuar fushat ndërhyrëse apo objektivat strategjike, që janë gjithsej katër. Konsultimet brenda Komunës që janë bërë për hartimin e këtij Plani, me grupin, që kemi mbajtur disa punëtori, është bërë postimi i saj në uebfaqen e Komunës, sipas procedurave (një muaj ditë). Po ashtu, u mbajtur takimi konsultativ me banorët. Dhe, pjesa e fundit është kostimi i këtij Plani, që ka qenë ndoshta një process më i rëndësishëm dhe gjithashtu ka marrë më shumë kohë për kostimin e çdo aktiviteti të tij. Rol të rëndësishëm ka pa drejtori i Financave, z.Qamil Kolloni, që më duhet ta falënderoj dhe jam mirënjohëse për angazhimin dhe vullnetin që ka treguar gjatë gjithë procesit, por specifikisht në procesin e kostimit. Të gjitha hapat e mësipërm shkojnë në një linjë, jo vetëm në detyrime kombëtare, por edhe në metodologjinë e përgatitjes, siç sugjerohet nga këshilli i bashkive dhe rajoneve të Evropës. Një rol të rëndësishëm në gjithë procesin e përgatitjes dhe finalizimin e këtij Plani, ka luajtur mbështetja dhe asistenca teknike e ofruar nga UN Eëomen, përmes një ekipi mirë të përgatitur si dhe një konsulenteje ndërkombëtare të angazhuar, dhe me mjete të BE-së të financuara me Projektin ‘Gender Equality Facility’. Ky Plan është një mjet praktik i lokalizimit të dokumenteve të rëndësishme kombëtare, por edhe ndërkombëtare, në lidhje me barazinë gjinore, veçanërisht instrumente drejtpërdrejt të aplikueshme me legjislacionin e vendit. Ky dokument është hartuar përmes procesit gjithëpërfshirës, me hapa të mirëpërcaktuar, me përmbajtje që reflektojnë arritjet dhe sfidat e ngjeshura ndër vite në Komunën e Dragashit dhe në përparimin e barazisë gjinore. Po ashtu, paraqet një pasqyrim të qartë të roleve dhe të përgjegjësisive të domosdoshme për t’u përmbushur nga ana e Komunës, si ndërmjet institucioneve lokale apo organizatave të shoqërisë civile, si dhe atyre ndërkombëtare, me qëllim të zbatimit në praktikë të parimit të barazisë për të gjithë, gratë e burrat, të rinjtë e të rejtat, vajzat e djemtë, në të gjithë diversitetin e tyre. Kur themi ‘në të gjithë diversitetin e tyre’, kemi parasysh se në Dragash jetojnë tri komunitete, po ashtu, brenda këtyre komuniteteve, përveç gjinisë ka edhe nënkategori

të ndryshme, që janë pleqtë, personat me aftësi të kufizuara etj. Domethënë, diversiteti i përfshin të gjithë. Çka me thënë tjetër, nuk e di sa ia vlen të ndalem, sepse e keni pas materialin, sigurisht e keni lexuar. Por, do të përmend që ky Plan, siç thashë më herët, i ka katër objektiva strategjike, me objektiva të ndryshme specifike dhe aktivitete të ndryshme. Do t'i përmend këta objektivat strategjike: Parimi në kuadrin e përgjithshëm të barazisë gjinore dhe fuqizimi i grave, të rejave, vajzave, në të gjithë diversitetin e tyre; Promovimi i të drejtave ekonomike, sociale dhe të punësimit të denjë, si dhe fuqizimi i vajzave të reja dhe grave; Zvogëlimi i pabarazive gjinore në arsimin cilësor, në kulturë e sport, për gratë e burrat, të rejtat e të rinjtë, vajzat dhe djemtë, në të gjithë diversitetin e tyre; dhe Promovimi i shëndetit dhe të drejtat seksuale e riprodhuese. Përparimi dhe efektiviteti i zbatimit të këtij Plani kërkon domosdoshmërisht vënien në dispozicion të burimeve të nevojshme dhe të mjaftueshme njerëzore, financiare e infrastrukturore, si dhe koordinimin e veprimeve dhe bashkëpunimin institucional me institucionet lokale, OShC-të, institucionet private, si dhe organizatat ndërkombëtare të cilat punojnë për fuqizimin e grave dhe arritjes së barazisë gjinore. Për fund, për mos me ju ndalë më tepër, deshta me shtu se rol të rëndësishëm në adresimin e çështjeve gjinore në nivel lokal luan edhe Grupi i Grave Asambleiste, që gjithsej për fat të mirë në Komunë e Dragashit kemi 10 asambleiste, të cilat mund të llobojnë vazhdimisht për sigurimin e fondeve dhe zbatueshmërinë e parashikuar të këtij Plani. Siç e dimë, Plani është e pamundur të realizohet pa ndihmën e donatorëve dhe pa mbështetjen e organizatave të ndryshme qeveritare dhe ndërkombëtare. Kaq kisha, nëse ka dikush më tepër i interesum në detaje, jam këtu për aq sa më takon, për fushëveprimin e aktiviteteve që unë e kam iniciativën, primatin. Varësisht prej drejtorive, mund të përgjigjen nesër drejtorët e secilës drejtori, të cilët këto aktivitete i kanë të parapara në planet e drejtorive të veta. Faleminderit për vëmendje!

Samidin Xheladini: Të nderuar të pranishëm, ju përsëndes të gjithëve! Deshta me e bo një pyetje, sot këtu me i trajtue disa tema. Ju na dhatë disa spjegime, por në material kemi pa edhe shuma. Ju nuk i përmendet shumë, që është shumë me rëndësi edhe kush financon. I pashë unë në material, por është mirë që ju si zyrtare, edhe Komitetit edhe Kuvendit t'ua jepni një pasqyrim më të detajuar, për mos me lënë dyshime. Dhe, përveç tjerash, është mirë që t'i përmbledhni ju si zyrtare edhe harxhimet e kaluara, Është mirë, sepse unë – janë edhe prezentë njerëzit të cilët kanë pas fjalë se Zyra për Barazi Gjinore ka dyshime se i ka keqpërdorur mjetet në të kaluarën. Jo për këtë mandate, por mandatet e kaluara. Është mirë që raportet e harxhimeve të të gjitha aktiviteteve, në vija të trasha, ta jepni ju para Kuvendit, se na Kuvendi gjithnjë i kemi votue ato planet edhe tash

duhet me veprue. Për me e fitue besimin, është mirë që ta keni një raport gjithëpërfshirës, në vija të trasha, për të kalumen, se kjo është folë prej njerëzve të cilët janë kompetent, me të thënë të drejtën, edhe është folë para dy viteve, edhe janë prezent këtu. Faleminderit!

Lindita Kozmaqi Piraj: E para, Samidin, për sqarimet e Planit, është Plani që rezulton me një përlllogaritje të koston në vlerë 1 milion e 800 mijë e diçka, duke përfshirë shuma totale të subvencioneve, granteve për panairë. Kur them subvencionet, këtu janë të përfshime subvencionet e bujqësisë, subvencionet e arsimit, bursat, subvencionet e shëndetësisë. Ka qenë e pamundur prej ekspertës me u nda, kur nuk ka qenë një plan dhe një raport se sa janë harxhuar vetëm specifikisht për gratë. Atëherë janë marrë komplet prej uebfaqes, shuma totale, edhe i janë shtu këtij, që në kuadër të atyre me pas edhe aktivitete që realizohen edhe për të drejtat e grave. Kjo e ka ngrit edhe këtë koston totale. Përveç tjerash, këtu, sipas ekspertit dhe metodologjisë më të re që është mbështet në Kartën Evropiane, e ka bërë përlllogaritjen edhe të kapacitetit njerëzor. Për shembull, në një aktivitet duhen tre zyrtarë: Unë, zyrtari për Komunitete, i Arsimit etj. Ky aktivitet kryhet me këta tre zyrtarë. Për sa ditë? Për pesë ditë, është pjestu me shumën e pagës që e marrim. Domethënë ne jemo veç në proces të punës, ne paguhemi, por aty është nxjerrë edhe kostoja ditore. Nuk është shtesë, por veç u përlllogarit, edhe kjo e ka ngrit këtë çmim të këtij Plani, të këtyre aktiviteteve. Përveç kësaj, edhe sallat e llogaritura për takime të ndryshme, për trajnime, për aktivitete, shkollat, shtëpitë e kulturës, të gjitha këto jau kanë nxjerrë koston kjo konsulentja edhe i ka vu këtu. Ato nuk janë investim shtesë, ato i kemi, i posedojmë, mirëpo këtu kanë ngrit këtë çështjen e buxhetit të këtij Plani. Ky është sqarimi unë që e kam. Për ma tepër, në detaje, mundet me sqaru drejtori i Financave, që ka qenë direkt i kyçur edhe që është ekspert në atë lëmi. Kjo ishte e para, për në detaje e keni materialin. Deri nesër, kush jeni të interesuar, mundeni me e lexu, shumë lehtë e zbërtheni se çka është. Është kaq e ndarë për këtë objektiv, kaq për këtë, kaq për këtë objektiv. Kaq janë kostot e krejt Komunës, infrastrukurore e me të gjitha. Në fund këtu, 720 janë një kosto që e mbulon donatori, një trajnim që ka me na bo tash së shpejti. Dhe 54 mijë e diçka prej totalit presin hendek financiar nga ndërkombëtarët, nga donatorët në këtë rast. Sa i përket pyetjes së dytë, për raporte e për keqpërdorime, mos folni me hamendësime, ka thënë ky e ka thënë ai, e ka thënë dikush që e njeh punën e s'ka thënë, thirrni konkretisht, shprehni ankesën, janë institucionet që mu më kanë vlerësu, janë eprorët e mi që i kanë vlerësu planet e mia, raportet e mia. Zyrtarja me kërkesa e ralizoj buxhetin, zyrtarja nuk ka buxhet personal të vetin, miratohet kërkesa prej kryetarit, i përgjigjem direkt si zyrtare kryetarit, e ralizoj qat aktivitet. Mjetet na nuk

i shohim me sy, siç e dinë ata që e njohin fushën e financave. Munden me folë ata të cilët nuk i njohin absolut financat, edhe folin në ajër edhe shprehin hamendësime. Është e drejta e tyre. E drejta jeme me jau dhënë këtë përgjigje është kështu: që Lindita nuk ka të bëjë direkt me financa, Lindita nuk është drejtoreshë, nuk posedon financa të vetat, Lindita e realizon çdo aktivitet me kërkesë. Dhe, në qoftë se kërkesa miratohet, e realizoj një aktivitet, i jap një drekë dikujt, siç ka ndodhë, një trajnim me mbajt, ose përmes tenderëve e bëj naj broshurë. Pothuajse shumica e aktiviteteve që Lindita i ka realizuar në Komunën e Dragashit, kanë qenë gjithmonë në bashkëpunim me donatorët, ku punën e kryej unë, me paret merren ata e s'i sheh Lindita. Kjo është diçka krejt...veç e folme kështu, po më vjen keq, si me thënë dikush kështu Out, që s'merr vesh kurrë me financa dhe me Asamble. Se përndryshe, kjo s'ka kurrfarë baze.

Nedžmidin Sejdilar: Përshëndetje të gjithëve, zonja Piraj, edhe mua më intereson atë çfarë kërkoi z.Xheladini, cila është shuma totale që do t'u kushtojë qytetarëve të kësaj komune. Nëse mund të vini pa pasur nevojë të justifikoheni sepse askush nuk ju ka akuzuar për fonde. Keni harxhuar kohë për justifikime dhe për faktin që nuk keni kontakt me paratë dhe askush nga ne nuk ju bëri një pyetje të tillë. Më intereson konkretisht vetëm nëse mund të na thoni sasinë totale të parave që do t'u kushtojë qytetarëve tanë. A janë 100, 150,000 vetëm një total për të na treguar se sa do të kushtojë kjo strategji.

Lindita Kozmaqi Piraj: z.Sejdilar, unë thashë edhe një herë, veç po më bjen prapë me u përsërit, se unë s'thashë po mbrohem. Më bëri pyetje z.Samidini, unë u përgjigja. Ajo shumë që është aty, që e keni ju përpara, që është e zberthyme, ajo është. Shkoni direkt te aktivitetet, totali është qajo. Mirëpo, specifikisht për secilin aktivitet, mundeni me shku me kqyr sa Komuna – 500 euro qetu, qekaq përqind ka me i dhënë dikush tjetër, donatori, qekaq i jep Komuna. Aty mandej janë të specifikume, salla bën qekaq, mëditja e zyrtarit që është në pagë e llogartime është qekaq, qekaq ka me i dhënë Komuna. Kështu ka shku përlllogaritja e konsulentit, unë nuk e kam bo Planin. Plani nuk është i jemi. Plani është i Komunës, por pse ka të bëjë specifikisht me barazinë gjinore, jam unë këtu për me i dhënë në tërësi një sqarim. Mirëpo, për drejtoritë e caktume, siç thashë edhe më herët, janë përgjegjës të gjithë drejtorët që nesër shpresoj janë këtu, edhe në qoftë se keni secili diçka, në shëndetësi, në arsim, në kulturë, ata direkt munden me u përgjigj vetë. Për ma tepër detaje të ndryshme, unë thashë, është drejtori këtu, mundet me ju dhënë përgjigje. Unë kaq di, kaq njoh, kaq kam punue, kaq kam pas kompetenca, kaq flas.

Miralem Rahte: Unë ju falënderoj. Unë nuk shoh ndonjë arsye për këtë lloj diskutimi në Komitetin për Komunitete, ky është një plan veprimi, dhe ju po bëni pyetje buxhetore, kështu që unë do ta ndaloj këtë diskutim dhe do ta vë në votim këtë pikë të rendit të ditës. Kush është pro, kundër, abstenim.

- Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës, formimin e Komisionit për Ankesa për shfrytëzimin afatshkurtër të paluajtshmërisë së komunës. A ka dikush një fjalë për pikën. Po e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës. Kush është pro, kundër, abstenime. Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës

- Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës: Propozim Vendimi për shfrytëzimin afatshkurtër të paluajtshmërisë së komunës O-70604014-10-3-2-0 ZK Dragash (Venezia). Po e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës. Kush është pro, kundër, abstenime.

- Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës: Propozim vendim për formimin e komisionit për vlerësimin e ofertave për shfrytëzimin afatshkurtër të pasurive të paluajtshme të bashkisë O-70604014-10-3-2-0. ZK Dragash, A ka dikush ndonjë koment në lidhje me artikullin. Po e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës. Kush është pro, kundër, abstenime.

- Kalojmë në pikën vijuese të rendit të ditës: Propozim Vendimi për shfrytëzimin afatshkurtër të paluajtshmërisë së komunës O-70604014-10-3-1-0 ZK Dragash (zyra ligjore-ish Pro Credit Bank) , A ka dikush fjalën në lidhje me këtë?dots. Po e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës. Kush është pro, kundër, abstenime.

- Kalojmë në pikën vijuese të rendit të ditës: Propozim vendim për formimin e komisionit për vlerësimin e ofertave për shfrytëzimin afatshkurtër të pasurive të paluajtshme të bashkisë O-70604014-10-3-1-0. ZK Dragash A ka ndonjë fjalë për artikullin. Po e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës. Kush është pro, kundër, abstenime.

- Kalojmë në pikën vijuese të rendit të ditës: Propozim Vendimi për shfrytëzimin afatshkurtër të paluajtshmërisë së komunës O-70604014-10-2-2-0 ZK Dragash (lokal përballë hotel "MEKA") , A ka dikush ndonjë koment në lidhje me artikullin . Po e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës. Kush është pro, kundër, abstenime.

- Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës: Propozim vendim për formimin e komisionit të vlerësimit të ofertave për shfrytëzimin afatshkurtër të pasurive të paluajtshme të bashkisë O-70604014-10-2-2-0. ZK Dragash A ka dikush ndonjë koment në lidhje me artikullin. Po e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës. Kush është pro, kundër, abstenime.

- Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës: Propozim vendim për shfrytëzimin afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës P-70604014-00771-0 ZK Dragash (Bufe në Shtëpinë e Kulturës-emri i mëparshëm "Montana"), A ka dikush fjalën në lidhje me artikullin. Po e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës. Kush është pro, kundër, abstenime.

- Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës: Propozim për vendim për formimin e komisionit për vlerësimin e ofertave për shfrytëzimin afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës P-70604014-00771-0 ZK Dragash. Po e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës. Kush është pro, kundër, abstenime.

- Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës: Propozim Vendimi për shfrytëzimin afatshkurtër të paluajtshmërisë së komunës P-70604014-00905-1 ZK Dragash (Parking dhe treg i gjelbër). Po e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës. Kush është pro, kundër, abstenime.

- Kalojmë në pikën vijuese të rendit të ditës: Propozim vendim për formimin e komisionit për vlerësimin e ofertave për shfrytëzimin afatshkurtër të paluajtshmërive të komunës P-70604014-00905-1 ZK Dragash , A ka dikush ndonjë koment në lidhje me artikullin. Po e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës. Kush është pro, kundër, abstenime.

- Kalojmë në pikën vijuese të rendit të ditës: Propozim vendim për shfrytëzimin afatshkurtër të paluajtshmërisë së komunës P-70604014-00782-2 ZK Dragash (Parking afër Gjykatës - Dragash), A ka dikush fjalë për pikën. Po e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës. Kush është pro, kundër, abstenime.

- Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës: Propozim për vendim për formimin e komisionit për vlerësimin e ofertave për shfrytëzimin afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës P-70604014-00782-2 ZK Dragash. Po e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës. Kush është pro, kundër, abstenime.

Pika e tretë e rendit të ditës

Miralem Rahte: A ka diskutues të tjerë? A ka ndonjë kërkesë dërguar Komisionit? A ka dikush një fjalë për pikën.

Nedžmidin Sejdilar: Është çmenduri të flasësh këtu fare. Edhe pse e keni uzurpuar atë pozicion, keni filluar t'i bëni këto takime si takimet e Kim Dyo Un. Ju po u shërbeni autoriteteve këtu që të na ndaloni të bëjmë ndonjë pyetje ose kur ne bëjmë një pyetje ku qeveria është në hall dhe nuk ka përgjigje, ju po na ndaloni diskutimin. Kështu bëtë ju disa muaj më parë kur i bëra zotit Kolonit pyetje thelbësore për furnizimin me ujë. Unë dola vetëm për Procesverbal, kështu që dikush nuk do të thoshin se ishin aty vetëm për të aminuar, 200 vjet pas, nëse dikush e lexon ndonjëherë këtë.

Miralem Rahte: A ka diskutues të tjerë? Meqenëse nuk ka, e mbyll seancën e sotme të këtij Komisioni. Faleminderit.

Kryesues i K.Komuniteteve

Miralem Rahte